# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-463836**
VERSIONI 2

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | De Laurentiis ka diçka për të thënë për të gjithë: E mbroj Malagò, 'Maradona Stadium' duhet të shembet, Spalletti duhet të kujtojë një gjë, ndërsa Cardinale… |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/23/de-laurentiis-ka-dicka-per-te-thene-per-te-gjithe-e-mbroj-malado-maradona-stadium-duhet-te-shembet-spalletti-duhet-te-kujtoje-nje-gje-ndersa-cardinale/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 19:04:09 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 23 shtator 2026, 18:16:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 23 shtator 2026, 18:15:00 UTC → 23 shtator 2026, 18:17:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `66d3e6e70d334812cc7c17a31002f47660fa72c94243aa298d93a823c4124739` |
| TEKSTI | `dbb12ca9368da6b1e16d362698e349890b0ae7a48c2c9619fcd5384b8ac764e0` |
| PAMJA | `db67b281056d9355085961a76f9193651c85ebda47c6c6551c10bd7f2df33a81` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ef7e180fab079e496a174ae6315b3d6b72c2b2f5e7c34c5e5bc8aa037faf26e5` |
| E MËPARSHMJA | `722865ea6a480da377d8a0792e63fbbfe51c9d02ae697d93b75328b15036c88b` |
| RRËNJA MERKLE | `dda7d23b558402c926cd6fed567bb6eba8126329f8a189914308aeb661b57cd2` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ef7e180fab079e496a174ae6315b3d6b72c2b2f5e7c34c5e5bc8aa037faf26e5`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# De Laurentiis ka diçka për të thënë për të gjithë: E mbroj Malagò, 'Maradona Stadium' duhet të shembet, Spalletti duhet të kujtojë një gjë, ndërsa Cardinale...

23/09/2026 20:16



**Presidenti i Napolit, Aurelio De Laurentiis është një vullkan i vërtetë kur behet fjalë për të thënë disa të vërteta dhe këtë e tregoi edhe këtë të mërkurë në një konference për shtyp në kuadër të ceremonisë së Cmimit Sportiv për Karrierën, një çmim që iu dha pikërisht De Laurentiis.**

Presidenti i klubit napoletan foli për shumë tema duke nisur nga çështja Malagò

*'Malagò po jeton një odise, e konsideroj si të vetmin që mund të vërë futbollin në binarët e duhur, e ka treguar këtë gjatë jetës së tij*-tha De Laurentiis-*por ne duhet të gjejmë me çdo kusht një mënyrë për ta rrëzuar, sepse dikush tjetër dëshiron që të marrë vendin e tij. Por kjo nuk është gjë e. mirë, nuk duhet politizuar futbolli. Politika gjithnjë ka munguar te kinematografia dhe te sporti, por kur duhet të vijnë të shohin ndonjë ndeshje vihen në radhë të parë për të siguruar bileta dhe zemërohen kur nuk ua jep'.*

Më pas në shënjestrën e De Laurentiis përfundon Luciano Spalletti.

*'Mos më bëni të flas për të*-vijoi presidenti i Napolit-*trajnerët duhet të kuptojnë se janë bashkëpunëtorë që thirren në apel për të drejtuar orkestrën e formuar nga futbollistët, por gjithsesi mbeten vartës. Ndonjehërë kanë tendencën për ta harruar. Është i qartë arsyetimi?'*

De Laurentiis ishte i qartë edhe përsa i përket Maradona Stadium.

*'Gjeta një zonë në Napolin Lindor për të ndërtuar një impiant të ri*-tha De Laurentiis-*projektova një stadium me 70 mijë vende me 120 sky box, restorante e gjithë të tjerat. Po kështu do të ketë edhe një muze ndërveprues, i realizuar me një agjentin tim në Los Angeles ku do të jetë e mundur që të luash virtualisht një ndeshje me këdo që dëshiron; Maradonën, Cavanin, Higuain. Për ta realizuar duhen kohë dhe miliona dollarë. Muzeun dedikuar Maradonës do ta realizoj në stadiumin e ti. 'Maradona Stadium' aktual duhet shembur. Pas 22 vitesh ku luhet në atë stadium që unë e kam përkufizuar shumë herë si WC, mund të them fare mirë se 200 milionë euro nuk shërbejnë për thuajse asgjë. Për të organizuar koncerte gjatë verës, kanë thyer edhe tubat e sistemit të ujitjes së fushës*

Dhe në fund erdhi edhe 'shigjeta e helmuar' në drejtim të pronarit të Milanit, Gerry Cardinale.

*'E ftova për darkë përpara 3 viteve, më mbajti një fjalim të cilin nuk e kundërshtova, përndryshe do të më duhej ta kapja e ta përzija jashtë*-tha De Laurentiis-*më thoshte gjëra që nuk qëndronin as në qiell e as në tokë sipas këndvështrimit tim; është një pronar që kishte pretendime si një financier, jo si një sipërmarrës i vërtetë'.*

## SPORT • KRYESORE



"Ka nga ata që duan të më vrasin"/ Ronaldo nuk kursehet ndaj kritikave: As me pushkë nuk ia dalin dot, unë i shmangem çdo plumbi



I akuzuar për përdhunim tre vite më parë, ylli i PSG-së del përpara gjykatës



Kaluan 43 vite nga periudha e Zicos dhe vjen princi nigerian apo artisti i modës, kush është në të vërtetë ylli i ri i Udineses



Kombëtarja dhe sfidat e Nations League, Daku: E rëndësishme të fitojmë, tani ndjejmë të kemi secili rëndësinë tonë




Kombëtarja, Seferi: Objektivi vendi i parë, Maran kërkon një lojë më ofensive

## ME TË LEXUARAT

Muçi si fabrikë golash e asistesh në Turqi, lë pas Salah për rastet e krijuara, shkëlqen edhe një tjetër shqiptar

"Do të largohem kur të mos më





‘Lufta e hapur’ mes Javier Tebas dhe Realit të Madridit: Përsa kohë Florentino do të jetë në krye, raportet janë të paripaueshme
23/09 22:14

Christian Eriksen dhe Wolfsburg marrin vendimin për të ardhmen e mesfushorit danez
23/09 21:48

Elbasani në hartën sportive të Europës, shpallet “Qyteti Europian i Sportit 2027”
23/09 21:47

## Na ndiqni:

Top Channel | Top Channel - Sport | @topchannelalbania | Top Channel

## Video »



Top Channel/ Arrestohet Shpëtim Aliu, “Kumbari” i drogës u kap në Rusi



Top Channel/ Berisha mbledh kryesinë për çështjen e SHISH: Nuk do bojkotojmë



Top Channel/ Zelensky: Putini është pacienti zero, ndalni paratë në Moskë



Top News- Berisha kërkon mobilizim. Zbardhen skenarët e demokratëve kundër socialistëve



Top Channel/ Rubio: Putin do të ftohet SHBA, do të jetë në Samitin e G20



Top News- Integrimi i Shqipërisë brenda 2027, Komisioni Evropian me plan të ri për anëtarësimin



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.